



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ZYRA E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË  
DREJTORIA EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

Nr. 1265 Prot.

Tiranë, më 18.04.2023

V E N D I M

Nr. 13, datë 18.04.2023

“PËR  
HAPJEN E PROCEDURËS SË PRANIMIT NË KATEGORINË E MESME  
DREJTUESE EDHE PËR KANDIDATË TË TJERË NGA JASHTË SHËRBIMIT CIVIL,  
PËR VITIN 2023”

Në mbështetje të nenit 147/d, të Kushtetutës, të pikës 3, të nenit 215, të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, si dhe të Kreut III, të VKM nr.242, datë 18.3.2015 “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese”, i ndryshuar si dhe të Vendimit të Kuvendit nr.10/2023 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Vendimin e Kuvendit nr.28/2020 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, në kuadër të plotësimit të vendeve vakante me qëllim mbarëvajtjen e punës së Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë,

V E N D O S A:

1. Për vitin 2023, procedura e plotësimit të pozicioneve të lira të kategorisë së mesme drejtuese, të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendet e lira.
2. Numri maksimal i pozicioneve, për të cilat do të përdoret procedura e përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, është 2 pozicione për kategorinë e mesme drejtuese, pozicioni “Ndihmës Inspektor, Njësia e Ndihmës Inspektorëve-Kategoria II-b”.
3. Ngarkohet Drejtoria Ekonomike dhe Shërbimeve Mbështetëse për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË

Artur Metani

